

# Programi i depistimit të kancerit të zorrës së trashë

## Çfarë përfshin ky program?

Në programin e depistimit të kancerit të zorrës së trashë, do të ftoheni rregullisht në një ekzaminim parandalues. Ju mund të zgjidhni midis analizës së jashtëqitjes (**çdo 2 vjet**) ose kolonoskopisë (**çdo 10 vjet**).

Kanceri i zorrës së trashë është një nga llojet më të zakonshme të kancerit. Nëpërmjet ekzaminimeve parandaluese, kanceri i zorrës së trashë mund të zbulohet herët, ose mund të parandalohet plotësisht duke hequr lezionet parakancerose. Sa më herët të zbulohet kanceri i zorrës së trashë, aq më efektiv mund të jetë trajtimi dhe aq më të mëdha janë shanset për t'u shëruar sërisht.

## Kush mund të marrë pjesë?

- Rezidentët në kantonin e Bernës
- Personat në moshën 50-69 vjeç
- Personat që nuk kanë bërë kolonoskopji gjatë 10 viteve të fundit (ata që kanë nevojë për ta bërë më shpesh, fatkeqësisht nuk lejohen të marrin pjesë)
- Personat që nuk kanë probleme me zorrën e trashë (parandalimi nënkuption ekzaminimin e hershëm pa pasur asnje simptomë)

## Sa kushton?

Shpenzimet paguhen nga shoqëria e sigurimeve shëndetësore, edhe nën shumën e zbritjeve vjetore. Ju paguani vetëm detyrimin e zbritshëm prej 10 %, pra rrëth **5 CHF** për një analizë jashtëqitjeje ose **70 – 150 CHF** për një kolonoskopji. Mund të aplikohen kosto shtesë për mjekun e përgjithshëm dhe për mjekimet për pastrimin e zorrës së trashë përpara kolonoskopisë.

## Analiza e jashtëqitjes apo kolonoskopia?

Ju mund të zgjidhni midis një analize jashtëqitjeje ose një kolonoskopie. Kolonoskopia rekomandohet qartë vetëm për personat me të afërm të ngushtë (prindër, vëllezër e motra, fëmijë) me kancer të zorrës së trashë. Mjeku juaj i familjes gjithashtu do t'ju ndihmojë.

### Pse duhet të zgjidhni analizën e jashtëqitjes?

Kur dëshironi të bëni një ekzaminim parandalues që është i besueshëm dhe mund të kryhet në shtëpi çdo 2 vjet. Kolonoskopia është e nevojshme vetëm nëse identifikohet gjak në jashtëqitje (rrëth 8 nga 100 persona).

### Pse duhet të zgjidhni kolonoskopinë?

Kur dëshironi të bëni një ekzaminim parandalues pak më kompleks që mund të kryhet vetëm nga një specialist çdo 10 vjet. Gjatë ekzaminimit mund të hiqen lezionet parakancerose (polipet).

## Si kryhet ekzaminimi?

Sigurohuni që të regjistroheni paraprakisht në [www.screening-be.ch/registrierung](http://www.screening-be.ch/registrierung). Për ta bërë këtë, ju duhet numri i referencës që ndodhet në pjesën e sipërme djathtas të ftesës suaj (kërkesë përmes faqes së internetit ose me telefon 031 529 3640).

### Procedura për analizën e jashtëqitjes

Pas regjistrimit, analizën do ta merrni me postë. Ju e bëni atë në shtëpi dhe e dërgoni përsëri në laboratori. Laboratori do t'i informojë për rezultatin me letër. Nëse nuk gjendet gjak në jashtëqitje, ju do ta merrni automatikisht testin e radhës me postë pas 2 vitesh. Nëse identifikohet gjak në jashtëqitje, duhet të kryhet një kolonoskopi për sqarim të mëtejshëm.

### Procedura për kolonoskopinë

Së pari, regjistrohuni online për kolonoskopinë tuaj. Më pas lini një takim për një praktikë gastrointestinale në programin kantonal (lista e praktikave pjesëmarrëse gjendet në faqen e internetit [www.screening-be.ch](http://www.screening-be.ch)). Në disa praktika mund të regjistroheni edhe drejtëpërdrejt. Ekzaminimi kryhet në klinikë / spital. Për procedurën dhe rezultatin do të informoheni direkt gjatë ekzaminimit.

**E RËNDËSISHME:** Merreni **konfirmimin tuaj të regjistrimit** me vete në të gjitha takimet mjekësore. Në këtë mënyrë ju informoni mjekun e familjes se ekzaminimi duhet **të kryhet në programin e depistimit kantonal** (jashtë këtij programi, shpenzimet duhet t'i mbuloni vetë).

## Keni Pyetje?

Jemi të lumtur t'ju ndihmojmë me telefon (**031 529 3640**) ose me email në ([screening-be@klbb.ch](mailto:screening-be@klbb.ch)).